KUJDES! MOS DËMTO BARKODIN

BARKODI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS
AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE

PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2011

S E S I O N I II

(I DETYRUAR)

VARIANTI A

E premte, 9 shtator 2011 **Ora 10.00**

Lënda: Letërsi dhe Gjuhë shqipe
Gjimnazi: Drejtimi natyror

Udhëzime për nxënësin
Testi është i ndarë në dy pjesë: në prozë dhe në dramë.
Testi në total ka **25 pyetje**.
Në të dyja pjesët ka pyetje me **zgjedhje** dhe me **zhvillim**. Në pyetjet me zgjedhje rrethoni **vetëm** shkronjën përbri përgjigjes së saktë, ndërsa për pyetjet me zhvillim është dhënë hapësira e nevojshme për të shkruar përgjigjen.
Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është **2 orë e 30 minuta**.
Pikët për secilën kërkesë janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7	8a	8b	9a	9b	9c	10a	10b	10c
Pikët															
Kërkesa	11a	11b	12a	12b	13	14	15	16	17	18	19a	19b	19c	20a	20b
Pikët															
Kërkesa	21a	21b	21c	22a	22b	23a	23b	24a	24b	25a	25b	25c	25d		
Pikët															

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1……...Anëtar

2. …….Anëtar

PJESA II

Shekspir Makbethi (fragment)

Akti III
Skena I

Makbethi
Ja mysafiri ynë kryesor.
Zonja Makbeth
Po ta harronim, festa jonë e madhe
Na mbetej si e çalë dhe pa shijë**.**
Makbethi
Zot, sonte kemi një gosti kremtore
Dhe lutemi të vish e ta nderosh.
Bankua
Si të urdhërojë Lartësia juaj.
Me ju detyra ime është e lidhur
Me një mënyrë që s'këputet kurrë.
Makbethi
A udhëton pas dreke?
Bankua
Po. imzot.
Makbethi
Kam dashur të të lypja ca këshilla-
Sikundër më përkrahe sot në mbledhje
Me aq zotësi dhe urtësi-
Po kemi kohë nesër. A shkon larg?
Bankua
Imzot, sa duhet për të mbushur kohën
Që këtë çast gjer në gosti të sotme;
Në qoftë se nuk më ecën kali mirë,
Besoj se do të arrij pasi të ngryset.
Makbethi
Mos na mungo nga festa.
Bankua
Aspak, Imzot.

Makbethi
Dëgjojmë se gjakderdhësit na shkuan
Njëri në Ingli dhe në Irlandë tjatri.
Që ta mbulojnë atvrasjen e pashpirtme,
Përhapin shpifje të çuditëshme;
Po dhe këto i bisedojmë nesër
Në mbledhjen e këshillës mbretërore,
Udhën e mbarë, pra; vrapo me kalin
Dhe kthehu shpejt. A e ke pas dhe djalin?
Bankua
Fleancin? Po, Imzot. Shkoj pra; s'pret koha.
Makbethi
Uroj të të ecë shpejt e mirë kali
Udhën e mbarë dhe u kthefsh shëndoshë. (Del Bankua)
Tani të gjithë jini të liruar
Gjer në orën shtatë gostisë sonë:
Që ta gëzojmë festën ca më bukur
Po çlodhemi pas dreke në odën vetëm.
Pra, gjer ahere, lamtumirë!

(Dalin të gjithë veç Makbethit dhe një shërbëtori.)

Dëgjo, a presin jashtë ata të dy?

Shërbëtori
Po, presin jashtë portës së pallatit.
Makbethi
Silli këtu, (Del Shërbëtori.)
Të jem kështu nuk është asgjë
Duhet të jem kështu me siguri.
Një frikë e thellë m'u rrënjos për Bankon:
Natyra mbretërore e tij më tremb;
se ka guxim dhe trimëri të madhe
Dhe i përdor me mend kur vepëron.
S'ka tjatër veç këtij që t'ia kem frikën;
gjenia ime kundrejt tij përunjet
Si Mark Antoni kundrejt Jul Qesarit.
I qërtoi motrat kur më quan mbret
Edhe i urdhëroi t'i flasin dhe atij;
Ahere me mënyrë profetike
E sallutuan gjysh prej disa mbretërsh.
Më vunë kokës një kurorë të papemët,
Më dhanë dhe një shkepter shterp në dorë,
Dhe fati m'i rrëmben pastaj të dyja,
Se s'kam trashëgimtar. Në qoftë ashtu,
Kam ndyrë shpirtin për të bijtë e Bankos,
Për ta kam vrarë Dunkanin hirëplot;
Për ta helmova qetësinë e mendjes;
Dhe xhevairin e përjetshëm ia dhashë;
Armikut të paudhë të skëterrës.
Që t'i bëj mbretër, bijtë e Bankos mbretër!
Që ta ndaloj këtë, eja, o fat,
Të kapemi për jetë dhe për vdekje!
Kush është ay? (Hyn Shërbëtori me dy Vrasës)
Tani shko, rri në derë,
Dhe prit atje gjersa të të thërres. (Del Shërbëtori.)
A nuk folëm dje bashkë?

*Për pyetjet nga 13-18 rrethoni **vetëm** alternativën e saktë.*

13. Ngjarja e kësaj tragjedie është marrë nga: **1 pikë**

A) Eposi i Nibelungëve
B) historia e Greqisë së vjetër
C) historia e Romës
D) historia e Skocisë mesjetare

14. Në vargun: *Udhën e mbarë, pra; **vrapo** me kalin*, folja me të zeza është në mënyrën: **1 pikë**

A) habitore
B) lidhore
C) urdhërore
D) dëftore

15. Vargu me intonacion pyetës: *Po kemi kohë nesër. A shkon larg*? tregon: **1 pikë**

A) natyrën hileqare të Makbethit
B) ndjesinë e Makbethit për diçka jo të mirë
C) dashurinë e Makbethit ndaj Bankos
D) kujdesin për të birin dhe familjen e Bankos

16. Krimi që mendohet të kryhet, motivohet me: **1 pikë**

A) xhelozinë e dashurisë
B) etjen për pushtet
C) inatet familjare
D) procesin e hakmarrjes

17. Fjala *gjakderdhësit* bën pjesë në klasën e: **1 pikë**

A) foljes
B) mbiemrit
C) përemrit
D) emrit

18. Karakteristikë e kësaj vepre është: **1 pikë**

A) ngjeshja e veprimit skenik
B) gjatësia e veprimit skenik
C) kompozicioni pa rend
D) mungesa e detajeve skenike

19. Cilat janë tri pikat e lidhjes së subjektit dramatik në këtë fragment? I jepni ato sipas radhës dhe peshës që kanë në rritjen e dramacitetit.

a) _____ **1 pikë**

b) _____ **1 pikë**

c) _____ **1 pikë**

20. Ç'kuptim ka shprehja: *Të kapemi për jetë dhe për vdekje!?* Identifikoni fjalët që formojnë antitezë.

a) _____ **1 pikë**

b) _____ _____ **1 pikë**

21. Pjesa e fundit është një monolog i Makbethit. Tregoni dy tipare të Makbethit që dalin prej këtij monologu.

a) _____ **1 pikë**

b) _____ **1 pikë**

c) Lexoni vargun: *Që ta ndaloj këtë, eja, o fat.* Ç'figurë e intonacionit është përdorur këtu? **1 pikë**

_____

22. Tregoni të paktën me nga një epitet ndryshimin thelbësor të karakterit të Makbethit dhe Bankos.

a) Makbethi: _____ **1 pikë**

b) Banko: _____ **1 pikë**

23. Cili është togfjalëshi që tregon natyrën e Bankos nga e cila ka frikë Makbethi dhe ç'klasa fjalësh e përbëjnë atë?

a) _____ **1 pikë**

b) _____ _____ **2 pikë**

24. Pse Makbethi i thërret vrasësit ***ata të dy?*** Ç'tregon kjo?

a) _____ **1 pikë**

b) _____ **1 pikë**

25. Argumentoni se edhe pasionet më të fuqishme te njeriu, duhet të udhëhiqen nga arsyeja.

8 pikë

Shtjellimi i idesë (25a)	Organizimi dhe struktura (25b)	Stili dhe origjinaliteti (25c)	Saktësia gjuhësore (sintaksa dhe drejtshkrimi) (25d)	**Totali 25**
2 pikë	**2 pikë**	**2 pikë**	**2 pikë**	**8 pikë**